

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/ PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr. 529/15

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, si dhe nenit 28 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në përbërje prej **Hysni Hoxha -Kryetar**, duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 529/15, të parashtruar nga OE “Euro Goma” sh.p.k. me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizimi me goma për automjete transportuese**” Lot 2, me nr.prok. KEKO/15/112/121, të iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK)–Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. (KEK), në seancën e mbajtur, më dt. 23 dhjetor 2015, mori këtë :

V E N D I M

MBI APROVIMIN E ANKESËS SË OE: “EURO GOMA” SH.P.K. PRISHTINË, NR. 529/15, TË DT. 30 NËNTOR 2015, SI TË BAZUAR

I. Apropohet, si e bazuar ankesa e OE “Euro Goma” sh.p.k. me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Furnizimi me goma për automjete transportuese**” Lot 2, me nr. prok. KEKO/15/112/121, iniciuar nga autoriteti kontraktues- Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.

II. Anulohet, vendimi i autoritetit kontraktues Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a., për dhënie të kontratës, për aktivitetit të prokurimit “**Furnizimi me goma për automjete transportuese**” Lot 2, me nr. prok. KEKO/15/112/121, dhe lënda kthehet ne Ri-tenderim.

Autoriteti kontraktues, në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

III. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron panelin shqyrtues që konformë dispozitave ligjore të nenit 25 paragrafi 8 dhe 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarrë masa ndaj autoritetit kontraktues dhe zyrtarit kryesor të prokurimit të autoritetit kontraktues. Sanksionet (masat ndëshkimore) të këtij vendimi janë të parashikuara në nenin e lartpërmendur.

IV. Operatorit ekonomik ankues “Euro Goma” sh.p.k. nga Prishtina, konformë nenit 118 pika 3 i’u kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë prej 500.00€ (pesëqind euro).

V. Urdhërohen, operatorët ekonomik ankues që konformë nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik “Euro Goma” sh.p.k. nga Prishtina, si palë të pa kënaqur, më dt. 30 nëntor 2015, ka parashtruar ankesën me nr. të prot. 529/15, kundër njoftimit për dhënie të kontratës OE “AMR GROUP” Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me goma për automjete transportuese” Lot 2, me nr. prok. KEKO/15/112/121, të iniciuar nga autoriteti kontraktues- Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. Duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së nr. 04/L-042 siç janë:

- Shkelje të nenit 28 të LPP-së, Specifikimet teknike;
- Shkelje të nenit 59 të LPP-së, Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
- Shkelje të nenit 69 të LPP-së, Aftësitë teknike dhe profesionale.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-ës nr. 04/L-042, me datën 11 dhjetor 2015, ka autorizuar ekspertin teknik Muhamet Kurtishaj, për të shqyrtuar zbatimin e aktivitetit të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues teknik, me datën 18 dhjetor 2015, i dorëzon panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raportin e ekspertizës lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoritetit kontraktues nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së, qëndron për arsye se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar produktet konform kërkesave teknike të dosjes së tenderit. Këtë fakti se bazuar në katalogun e ofruar si dëshmi shihet se i njëjti e ka ofruar goma të tipit RADIAL, me dimensionet 395/85R20TL, nga shihet se i mungojnë indexet XZL, indexi XZL është simbol i prodhuesve të gomave MICHELIN.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 28 të LPP-së, eksperti shqyrtues teknik sqaron se qëndron për arsye se nga autoriteti kontraktues në specifikacion teknik i dhënë në dosjen e tenderit ju ka referuar prodhuesit të gomave “MICHELIN” duke përdorur në dy raste në pozicionet 2 dhe 5, simboli XZL dhe XDY të këtij prodhuesi.

Eksperti shqyrtues-teknik, në raportin e ekspertizës i rekomandon panelit shqyrtues që të aprovoj si të bazuar ankesa e operatorit ekonomik ankues, si dhe të rekomandohet autoriteti kontraktues të anulohet aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me goma për automjete transportuese” Lot 2.

Autoriteti kontraktues Korporata e Energjetike e Kosovës sh.a., përmes parashtrësës me shkrim të dt. 22 dhjetor 2015, e njofton panelin shqyrtues se nuk pajtohen me konstatimet dhe mendimin e ekspertëve shqyrtues teknik të dhënë në raportin e ekspertizës së dt. 18 dhjetor 2015.

Operatorët ekonomik ankues përmes parashtrësës me shkrim të dt. 22 dhjetor 2015, e njoftoj panelin shqyrtues se nuk pajtohet me konstatimet dhe mendimin e ekspertit shqyrtues teknik të dhënë në raportin e ekspertizës së dt. 18 dhjetor 2015.

Me rastin e procedurës para këtij organi u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimit për kontratë, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik ankues, raporti i ekspertit shqyrtues teknik i dt. 18 dhjetor 2015, si dhe parashtrësja e autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues mbi raportin e ekspertit shqyrtues teknik.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoritetit kontraktues ka bërë shkelje të nenit 28 të LPP-së, paneli shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues teknik konstaton se qëndron për arsye se autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit respektivisht në specifikacionin teknik ju ka referuar prodhuesit të gomave "MICHELIN" duke përdorur në dy raste në pozicionet 2 dhe 5, simboli XZL dhe XDY të këtij prodhuesi.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së, paneli shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues teknik konstaton se qëndron për arsye se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar produktet konformë kërkesave teknike të dosjes së tenderit. Këtë fakti se bazuar në katalogun e ofruar si dëshmi shihet se i njëjti e ka ofruar goma të tipit RADIAL, me dimensionet 395/85R20TL, nga shihet se i mungojnë indexet XZL, indexi XZL është simbol i prodhuesve të gomave MICHELIN.


Paneli shqyrtues bazuar në nenin 59 pika 4 të LPP-së, konstaton se një operator ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet të prokurimit, është i përgjegjshëm vetëm nëse i ka plotësuar kërkesat e përzgjedhjes dhe specifikimit teknik të kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, ndërsa në rastin konkret operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar produktet konformë kërkesave teknike të dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes së tenderit, konstatimeve të cekura në ekspertizën e ekspertit shqyrtues teknik, shqyrtimit të pikave pretenduese të operatorit ekonomik ankues, konstatoj se autoritetit kontraktues me rastin e hartimit të specifikave teknike dhe gjatë procesit të vlerësimit të ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me goma për automjete transportuese" Lot 2.", nuk ka respektuar nenin 28 dhe 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart, konformë nenit: 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike :

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mundë të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë kërkesëpadi pranë Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative.



Vendimi t'i dorëzohet:

1. 1x1 ekzemplar AK –Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.
2. 1x1 ekzemplar OE “Euro Goma” sh.p.k. Prishtinë
3. 1x1 ekzemplar Arhivës së OSHP-së